

KRYQI I KUQ SHQIPTAR

STATUTI

I

KRYQIT TË KUQ SHQIPTAR

Miratuar nga Asambleja e Parë e Përgjithshme e KKSH-së më 23-24 Nëntor 1992, rishikuar në Asamblenë e Dytë më 22-23 Qershor 1995, në Asamblenë e Katërt më 27-29 Tetor 2000 dhe në Asamblenë e Njëmbëdhjetë më 10 Nëntor 2007.

Tiranë, 2007

Kapitulli I DISPOZITA TE PËRGJITHSHME

- Neni 1 - Parimet themelore
- Neni 2 - Misioni i Kryqit te Kuq Shqiptar
- Neni 3 - Karakteri Kombëtar
- Neni 4 - Karakteri Ndërkombëtar
- Neni 5 - Emblema
- Neni 6 - Struktura

Kapitulli II OBJEKTIVI

- Neni 7 - Objektiv i përgjithshëm dhe synimet kryesore

Kapitulli III ANËTARET

- Neni 8 - Përbërja e shoqatës
- Neni 9 - Kriteret e anëtarësimit
- Neni 10 - Të drejtat e anëtarit
- Neni 11 - Detyrat e anëtarit
- Neni 12 - Humbja e cilësisë së Anëtarit

Kapitulli IV ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME

- Neni 13 - Përbërja
- Neni 14 - Kompetencat
- Neni 15 - Sesionet
- Neni 16 - Procedurat

Kapitulli V KËSHILI DREJTUES

- Neni 17 - Përbërja
- Neni 18 - Kompetencat
- Neni 19 - Sesionet
- Neni 20 - Procedurat
- Neni 21 - Presidenti
- Neni 22 - Komisioni i financës
- Neni 23 - Komisioni i vrojtimit – verifikimit
- Neni 24 - Sekretari i Përgjithshëm

Kapitulli IV DEGA E KRYQIT TË KUQ SHQIPTAR

- Neni 25 - Roli dhe organizimi i degës
- Neni 26 - Asambleja e degës
- Neni 27 - Këshili i degës
- Neni 28 - Shpërndarja e Këshillit të degës
- Neni 29 - Modalitetet e shpërndarjes

Kapitulli VII ZGJEDHEJT/ROTACIONI/PROFILET

- Neni 30 - Zgjedhjet
- Neni 31 - Kohëzgjatja e mandatit
- Neni 32 - Rotacioni
- Neni 33 - Profilet

Kapituli VIII USHTRIMI I FUNKSIONEVE

- Neni 34 - Ushtrimi falas i funksioneve të zgjedhura
- Neni 35 - Respektimi i asnjësisë
- Neni 36 - Përpikmëria e anëtarëve të zgjedhur

Kapituli IX DISPOZITA FINANCIARE

- Neni 37 - Të përgjithshme
- Neni 38 - Administrimi dhe kontrolli
- Neni 39 - Viti financiar
- Neni 40 - Të ardhurat
- Neni 41 - Raporti administrativ
- Neni 42 - Buxheti
- Neni 43 - Kontrolli i llogarive

Kapitulli X DISPOZITA TË FUNDIT

- Neni 44 - Rishikimi i statutit
- Neni 45 - Rregulloret
- Neni 46 - Shpërndarja
- Neni 47 - Hyrja në fuqi

KAPITULLI I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

PARIMET THEMELORE

Kryqi i Kuq Shqiptar është shoqatë e pavarur, humanitare, vullnetare e themeluar në Tiranë më 4 Tetor 1921 dhe miratuar me dekret Nr. 246/I, datë 4 Maj 1922 të Këshillit të Lartë të Shtetit. Kryqi i Kuq Shqiptar vepron në bazë të ligjit nr.7864, datë 29 Shtator 1994. Ai mbështetet në Konventat e Gjenevës të vitit 1949 dhe në protokollet shtesë të vitit 1977, ku ka aderuar dhe Shqipëria, si dhe në Parimet Themelore të Lëvizjes Ndërkombëtare të Kryqit të Kuq dhe të Gjysëm Hënës së Kuqe:

Humanizmi

E lindur nga dëshira për t'u ardhur në ndihmë pa asnjë dallim të plagosurve në fushën e betejës, Lëvizja Ndërkombëtare e Kryqit të Kuq dhe Gjysëm Hënës së Kuqe (Lëvizja), në planin ndërkombëtar dhe kombëtar, përpiqet në çdo rrethanë të parandalojë dhe të lehtësojë vuajtjet e njerëzve. Ajo synon mbrojtjen e jetës dhe të shëndetit të njeriut si dhe respektimin e tij; përkrah mirëkuptimin e ndërsjellë, miqësinë, bashkëpunimin dhe një paqe të qëndrueshme ndërmjet të gjithë popujve.

Paanësia

Lëvizja nuk bën asnjë dallim për arsye kombësie, race, feje, gjendjeje shoqërore apo përkatësie politike dhe ideologjike.

Asnjënia

Me qëllim që të ketë gjithnjë besimin e të gjithëve, Lëvizja nuk merr pjesë në konflikte dhe nuk përzihet asnjëherë në polemikat me karakter politik, racial, fetar apo ideologjik.

Pavarësia

Lëvizja është e pavarur. Ajo është ndihmëse e pushteteve publike në veprimtaritë e tyre humanitare dhe u nënshtrohet ligjeve të vendeve përkatëse, megjithatë Shoqatat Kombëtare të Kryqit të Kuq duhet të ruajnë një autonomi që lejon të veprojnë gjithnjë sipas parimeve të Lëvizjes.

Vullnetarizmi

Ajo është një Lëvizje që jep ndihmë vullnetare dhe pa interes .

Uniteti

Nuk mund të ketë veçse një shoqatë të Kryqit të Kuq ose të Gjysmë Hënës së Kuqe në të njëjtin vend .Ajo duhet të jetë e hapur për të gjithë dhe të shtrijë veprimtarinë e saj humanitare në të gjithë territorin.

Universaliteti

Lëvizja Ndërkombëtare e Kryqit të Kuq dhe Gjysmë Hënës së Kuqe, në gjirin e së cilës të gjitha shoqatat kanë të drejta të barabarta dhe detyrë të ndihmojnë njëra tjetrën, është e përbotshme.

Neni 2

MISIONI I KRYQIT TË KUQ SHQIPTAR

Kryqi i Kuq Shqiptar ndihmon njerëzit më në nevojë duke mobilizuar forcën e humanizmit të shoqërisë nëpërmjet veprimtarisë së vet humanitare. Misioni i Kryqit të Kuq Shqiptar është i bazuar në Parimet Themelore të Lëvizjes Ndërkombëtare të Kryqit të Kuq dhe të Gjysmë Hënës së Kuqe.

Neni 3

KARAKTERI KOMBËTAR

KKSH ushtron veprimtarinë e tij si e vetmja shoqatë e Kryqit të Kuq në të gjithë territorin e Shqipërisë.

KKSH është ndihmës i autoriteteve publike dhe i shërbimeve shëndetësore ushtarake në përputhje me Konventat e Gjenevës. Ky rol ndihmës nuk mund të ushtrohet në kundërshtim me Parimet Themelore.

KKSH është person juridik.

KKSH ka një kohëzgjatje të pakufishme.

KKSH ka selinë në Tiranë.

Neni 4

KARAKTERI NDËRKOMBËTAR

KKSH është njohur nga KNKK më 02.08.1923.

- Është anëtar i Federatës Ndërkombëtare të Kryqit të Kuq dhe Gjysëmhënës së Kuqe.
- Si anëtare e saj KKSH përmbush detyrat humanitare në përputhje dhe në respektim të statuteve dhe Parimeve Themelore të Lëvizjes Ndërkombëtare të K K dhe GJHK

Neni 5

EMBLEMA

KKSH ka për emblemë shenjën heraldike të Kryqit të Kuq mbi një sfond të bardhë, në përputhje me konventat e Gjenevës dhe me të Drejtën Ndërkombëtare në fuqi, si dhe me objektivat e parashikuara nga Konferencat Ndërkombëtare të Kryqit të Kuq dhe Gjysëmhënës së Kuqe.

Neni 6

STRUKTURA

Kryqi i Kuq Shqiptar përbëhet nga organet qendrore dhe ato të degëve:

Organet qendrore janë:

- Asambleja e Përgjithshme
- Këshilli Drejtues

Organet e degëve janë:

- Mbledhja e anëtarëve të degës
- Këshilli i degës

KAPITULLI II

OBJEKTIVI

Neni 7

OBJEKTIVI I PËRGJITHSHËM

Kryqi i Kuq Shqiptar ka si objektiv të përgjithshëm parandalimin dhe lehtësimin e vuajtjeve me paanësi të plotë, pa asnjë dallim kombësie, race, prejardhje shoqërore, feje a bindje politike.

Për këtë qëllim synimet e tij janë sidomos:

1. Të veprojnë në rast konflikti të armatosur dhe në kohë paqe, si ndihmës i shërbimeve sanitare në të gjitha fushat e parashikuara në Konventat e Gjenevës në favor të të gjitha viktimave të luftës qofshin civile o ushtarake.
2. Të kontribuojë në përmirësimin e gjendjes sociale dhe shëndetësore, për parandalimin dhe lehtësimin e vuajtjeve me programe formuese dhe ndihmë të ndërsjelltë në shërbim të shoqërisë, programe që t'u përshtaten nevojave dhe kushteve kombëtare e lokale
3. Të ndihmojnë shërbimet publike në favor të viktimave në raste fatkeqësish masive.
4. Të rekrutojnë, të formojë dhe të caktojë personelin e nevojshëm për përmbushjen e detyrave që i janë besuar Kryqit të Kuq Shqiptar.
5. Të nxisë mirëkuptimin, mbështetjen dhe kontributin e publikut të gjerë për veprimtarinë e Kryqit të Kuq.
- 6- Të inkurajojnë pjesëmarrjen e të rinjve në veprimtarinë e Kryqit të Kuq, duke nxitur aktivizimin e tyre në të gjitha nivelet e shoqatës.
- 7- Të përhapë Parimet Themelore të Lëvizjes Ndërkombëtare të KK dhe GJHK dhe të së Drejtës Ndërkombëtare Humanitare në gjirin e popullit dhe, në veçanti, te fëmijët e të rinjtë, si dhe idealet

e paqes, respektit dhe mirëkuptimit të ndërsjelltë ndërmjet të gjithë njerëzve dhe të gjithë popujve.

8. Të zhvillojë avokacinë në të mirë të njerëzve në nevojë.

KAPITULLI III

ANËTARËT

Neni 8

PËRBËRJA E SHOQATËS

Kryqi i Kuq Shqiptar është i hapur për cilindo shtetas shqiptar pa asnjë dallim (race, etnie, gjinie, moshe, shtrese shoqërore, besimi fetar dhe bindjeje politike).

KKSH ka anëtarë të regjistruar dhe anëtarë aktivë (vullnetarë).

- Anëtarë të regjistruar janë ata të cilët paguajnë kuotizacionin vjetor të caktuar nga Asambleja e Përgjithshme.
- Anëtarë aktivë janë anëtarët e regjistruar të cilët marrin pjesë vullnetarisht në veprimtaritë e Kryqit të Kuq dhe janë të regjistruar si të tillë nga Këshilli i degës.
- Shoqata mund të ketë edhe *anëtarë nderi*, një titull që mund t'u jepet nga Këshilli Drejtues, personave që i kanë bërë shërbime të jashtëzakonshme Kryqit të Kuq Shqiptar. Shoqata organizon gjithashtu një sistem për shprehjen e falenderimit dhe mirënjohjes për anëtarët dhe vullnetarët më të shquar si dhe dashamirësit e Kryqit të Kuq jashtë shoqatës.

Neni 9

KRITERET E ANËTARËSIMIT

Anëtar i KKSH-së bëhet ai që:

- Pranon Parimet Themelore të Lëvizjes Ndërkombëtare të KK dhe GJHK
- Ka moshën mbi 16 vjeç
- Pagan kuotizacionin e Shoqatës.
- Rregjistrohet nga një prej degëve të KKSH-së.

Neni 10

TË DREJTAT E ANËTARIT

Anëtari aktiv dhe i regjistruar ka të drejtë:

- Të votojë;
- Të zgjedhë dhe të zgjidhet. Ai nuk mund të zgjidhet duke qenë i punësuar në KKSH;
- Të marrë pjesë në Mbledhjen e anëtarëve të degës
- Të shprehë mendime dhe të paraqesë propozime për mbarëvajtjen e Shoqatës në çdo nivel të saj.

Neni 11

DETYRAT E ANËTARIT

- Të njohë, të zbatojë dhe të përhapë Parimet Themelore të Lëvizjes Ndërkombëtare të KK dhe GJHK;
- Të promovojë Misionin e Shoqatës;
- Të njohë dhe të respektojë statutin;
- Të punojë për ruajtjen dhe forcimin e imazhit të shoqatës, në përputhje me kodin e saj etik.

Neni 12

HUMBJA E CILËSISË SË ANËTARIT

Cilesia e të qenit anëtar humbet kur personi:

- Nuk paguan kuotizacionin deri në fund të vitit kalendarik;
- Përrjashtohet nga Dega për:

a- Shkelje të rënda të Parimeve Themelore të Lëvizjes Ndërkombëtare të KK dhe GJHK;

b- Kryen veprime që cënojnë rëndë imazhin e Shoqatës;

Çdo anëtar i përjashtuar ka të drejtë të Apelojë pranë Këshillit Drejtues, vendimi i të cilit ka karakter përfundimtar dhe forcë detyruese.

Këshilli Drejtues vendos një rregullore për procedurën e apelimit, në mënyrë që të garantohet paañësia e këtij të fundit.

KAPITULLI IV

ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME

Neni 13

PËRBËRJA

Asambleja e Përgjithshme është organi me autoritetin më të lartë në KKSH. Ajo përfaqëson tërësinë e Kryqit të Kuq Shqiptar dhe përbëhet nga:

- Anëtarë të Këshillit Drejtues
- Kryetarë të Degëve.
- Delegatë të degëve, numri i të cilëve caktohet nga Këshilli Drejtues në përpjestim me numrin e anëtarëve të regjistruar dhe aktivë.

Në seanca të veçanta, në cilësinë e vëzhguesit marrin pjesë përfaqësues nga dikastere, organizata dhe institucione me interes për veprimtarinë e KKSH-së.

Neni 14

KOMPETENCAT

Asambleja e Përgjithshmevendos për të gjitha çështjet e përfshira në rendin e ditës me propozim të Këshillit Drejtues, i cili ka mbajtur parasysh dhe çështje të propozuara dhe të drejtuara nga anëtarët, së paku një muaj para mbajtjes së Asamblesë së Përgjithshme.

Asambleja e Përgjithshme:

- a) Miraton statutin dhe amendimet eventuale.
- b) Propozon amendamente për Ligjin e KKSJ dhe ligjet e tjera që kanë lidhje me të.
- c) Përcakton misionin dhe politikat mbi të cilat bazohet veprimtaria e Shoqatës.
- d) Dëgjon, diskuton dhe miraton raportin e Presidentit mbi gjendjen e shoqatës, dhe raportin e Sekretarit të Përgjithshëm mbi veprimtarinë e shoqatës.
- e) Miraton planet e zhvillimit si dhe buxhetet dhe raportet financiare vjetore të Shoqatës.
- f) Dëgjon dhe shprehet mbi raportin e kontrollit financiar.
- g) Miraton bilancin për periudhën e kaluar.
- h) Zgjedh Presidentin e Shoqatës.
- I) Zgjedh zv Presidentin.
- j) Zgjedh anëtarët e Këshillit Drejtues
- k) Zgjedh kryetarin dhe anëtarët e Komisionit të Financës, Komisionit të Vrojtim - Verifikimit.
- l) Vendos krijimin e degëve.
- m) Cakton kuotën e anëtarësisë.

Neni 15

SESIONET

Asambleja e Përgjithshme mblidhet në sesion të zakonshëm një herë në dy vjet, në kohën dhe vendin e caktuar prej saj, përveç rasteve kur Këshilli Drejtues e konsideron praktikisht të pamundur mbledhjen e saj.

Asambleja e Përgjithshme thirret në sesion jashtë radhe me vendim të Këshillit Drejtues, ose me kërkesë të një së pestës së anëtarëve të Asamblesë së Përgjithshme. Në të gjitha rastet thirrja e Asamblesë bëhet jo më vonë se një muaj përpara datës së mbledhjes.

Neni 16

PROCEDURAT

Asambleja e Përgjithshme merr të gjitha vendimet në prani të së paku 60% të anëtarëve të saj dhe me votat e shumicës së anëtarëve të pranishëm që kanë të drejtë vote, përveç rasteve të veçantë kur në Statut parashikohet ndryshe.

Asambleja e Përgjithshme jashtë radhe merr vendim në prani të së paku 2/3 –s së anëtarëve të saj dhe me votat e shumicës së anëtarëve të pranishëm.

Çdo anëtar i Asamblesë së Përgjithshme ka të drejtën e një vote.

KAPITULLI V

KËSHILLI DREJTUES

Neni 17

PËRBËRJA

Kryqi i Kuq Shqiptar, ndërmjet sesioneve të Asamblesë së Përgjithshme, drejtohet nga një Këshill Drejtues i përbërë nga:

- a) Presidenti
- b) Zv.presidenti.
- c) Kryetari i Komisionit të Financave
- d) Gjashtë anëtarë të zgjedhur ndër kryetarët e degëve.
- e) Katër anëtarë të zgjedhur ndër anëtarët aktivë të Shoqatës.

Neni 18

KOMPETENCAT

Këshilli Drejtues vendos për të gjitha çështjet e rëndësishme që paraqesin interes për jetën dhe qëllimet e KKSH-së. Ai zbaton politikën e përgjithshme të KKSH-së për të cilën përgjigjet para Asamblesë së Përgjithshme.

Në mënyrë të veçantë:

- a- Eshhtë garant i zbatimit të bazës ligjore të Shoqatës dhe kujdeset që ajo të jetë aktuale dhe e përshtatur në kushtet konkrete .
- b- Zgjedh Kryetarin dhe anëtarët e Komisionit të Kandidimit.
- c- Propozon në Asamblenë e Përgjithëshme krijimin e degëve.
- d- Vendos të shpërndajë Këshillin e degës.
- e- Merr vendime për përparësitë dhe dinamikën e zhvillimit të veprimtarisë.
- f- Përcakton politikën për stafin dhe vullnetarët.
- g- Vendos standarte vlerësimi dhe përcakton rezultatet e performancës së Shoqatës.
- h- Miraton dhe ndryshon rregulloret për të bërë sa më efektiv Statutin e Shoqatës .
- i- Ngre komisione që i gjykon të nevojshme. Përbërja, mandati dhe funksionimi i tyre përcaktohet në Rregulloren e Brendshme.
- j- Siguron zbatimin e politikës së Shoqatës për vendosjen e marrëdhënieve dhe partneriteteve .
- k- Siguron që përdorimi i burimeve financiare e materiale të jetë në pajtim me parimet e Shoqatës .
- l- Shprehet për veprimet e ndërmarra nga Presidenti në periudhën ndërmjet mbledhjeve të Këshillit Drejtues.
- m- Emëron Sekretarin e Përgjithshëm, përgjegjësat e njësive të Sekretariatit dhe përcakton detyrat dhe kompetencat e tyre.
- n- Cakton subjektet auditues për kontrollin vjetor të llogarive të Shoqatës.
- q - Vlerëson çdo vit performancën e Sekretarit të Përgjithshëm.

Neni 19

SESIONET

Këshilli Drejtues thirret nga Presidenti, në sesion të zakonshëm të paktën një herë në dy muaj. Sesioni jashtë radhe i Këshillit Drejtues thirret nga Presidenti, me iniciativën e tij, me kërkesën e një të tretës së anëtarëve të Këshillit, ose me kërkesë të Sekretarit të Përgjithshëm, drejtuar Presidentit. Për çështje të veçanta të rëndësishme, kur Këshilli Drejtues nuk mund të mblidhet, Presidenti, tërheq mendimin dhe konsultohet me anëtarët e Këshillit dhe merr vendim në përputhje me nenin 20.

Neni 20

PROCEDURAT

Këshilli Drejtues i merr të gjitha vendimet në prani të jo më pak se gjysmës së anëtarëve të tij dhe me votat e shumicës së anëtarëve të pranishëm. Në rast të ndarjes së barabartë të votave, ajo e Presidentit është përcaktuese.

Çdo anëtar i Këshillit Drejtues ka të drejtën e një vote.

Neni 21

PRESIDENTI

Është personaliteti më i lartë i Shoqatës .

Vepron nën autoritetin e Asamblesë së Përgjithshme dhe të Këshillit Drejtues për drejtimin e Shoqatës në përputhje me vendimet që janë marrë.

Është përgjegjës para Asamblesë së Përgjithshme për kompetencat që ka:

a- Garantimi i zbatimit të parimeve të Shoqatës.

b- Kujdesi për respektimin e Statutit dhe të Rregullores së Brendshme .

c-Bashkërendimi i veprimtarisë të organeve të Shoqatës.

d- Përfaqësimi i Shoqatës në rang kombëtar dhe ndërkombëtar.

e- Kryesimi i sesioneve të Asamblesë së Përgjithshme e të Këshillit Drejtues.

f- Ushtrimi i autoritetit të tij mbi degët dhe mbi Shoqatën kombëtare në tërësi.

g- Ndërmerr masat e domosdoshme në intervalin ndërmjet dy mbledhjeve të Këshillit Drejtues dhe më pas raporton në mbledhjen më të afërt të tij.

h- Rekomandimi i Sekretarit të Përgjithshëm për emërim.

i- Kryerja e çdo funksioni tjetër që i besohet nga Asambleja e Përgjithshme dhe Këshilli Drejtues. Presidenti mund t'i ngarkojë Zv.Presidentit një pjesë të funksioneve.

Në rastin kur posti i Presidentit mbetet i lirë ose kur Presidenti nuk është në gjendje të kryejë funksionet e tij, zëvendësohet nga Zv.Presidenti deri në sesionin e ardhshëm të Asamblesë së Përgjithshme. Në këtë sesion Asambleja e Përgjithshme zgjedh Presidentin për të plotësuar vendin e lirë për periudhën që mbetet në vazhdim.

Neni 22

KOMISIONI I FINANCËS

1- PËRBËRJA

Komisioni i financës përbëhet nga Kryetari dhe pesë anëtarë të zgjedhur nga Asambleja e Përgjithshme nga lista e kandidatëve të propozuar nga Këshilli Drejtues.

2- FUNKSIONET

a- Mbikqyr të gjitha çështjet financiare të shoqatës, mbledhjen, administrimin dhe investimin e fondeve dhe i paraqet Asamblesë së Përgjithshme dhe Këshillit Drejtues rekomandimet e nevojshme.

b- Bën komente për raportin financiar dhe buxhetin vjetor të hartuar nga Sekretari i Përgjithshëm dhe i paraqet ato në organet përkatëse.

c-Asiston Këshillin Drejtues në zbatimin e vendimeve të Asamblesë se Përgjithshme për administrimin financiar të Shoqatës .

d-Raporton veprimtarinë e tij në çdo sesion të Asamblesë së Përgjithshme .

Për kryerjen e funksioneve të tij, Komisionit të Financës i vihen në dispozicion të gjithë informacionet e dokumentat me karakter financiar.

3-MBLEDHJET / PROCEDURAT

Procedura e mbledhjeve të Komisionit të Financës përcaktohen në Rregulloren e Brendëshme.

Neni 23

KOMISIONI I VROJTIM-VERIFIKIMIT

1) PËRBËRJA

Komisioni i Vrojtimit - Verifikimit përbëhet nga kryetari dhe tre anëtarë, të zgjedhur nga Asambleja e Përgjithshme nga lista e kandidatëve të propozuar prej Këshillit Drejtues.

2) FUNKSIONET

a)Komisioni i Vrojtimit - Verifikimit me kërkesë të Presidentit ose të Këshillit Drejtues, vepron për të vrojtuar dhe verifikuar probleme të veçanta.

b)Kur është e nevojshme, Komisioni verifikon dokumentat e nxjerra për situatën që është në shqyrtim.

c) Përfundimet e vrojtimit dhe verifikimit Komisioni ia paraqet Presidentit dhe Këshillit Drejtues.

Neni 24

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Emërohet nga Këshilli Drejtues sipas kërkesave të përcaktuara më parë prej tij. Eshtë funksionari drejtues ekzekutiv kryesor i Kryqit të Kuq Shqiptar. Në veprimtarinë e tij zbaton Statutin, Rregulloren e Brendshme dhe dokumentat e tjera të rëndësishme të KKSH-së, si dhe vendimet e orientimet e Asamblesë, Këshillit Drejtues dhe Presidentit. Raporton në organet drejtuese veprimtarinë e Shoqatës për periudhën ndërmjet dy mbledhjeve . Përcakton strukturën e Sekretariatit dhe e paraqet për miratim në Këshillin Drejtues. Lidh kontrata me të punësuarit e shoqatës sipas procedurave të përcaktuara në Rregulloren e Brendshme. I propozon Këshillit Drejtues kandidatët për përgjegjës njësie. Kryen funksionin e sekretarit të Asamblesë, të Këshillit Drejtues dhe të komisioneve të ngritura prej tyre. Sekretari i Përgjithshëm mund t'ia delegojë këtë funksion punonjësve të tjerë të Sekretariatit. Ai ka rol këshillimor në këto organe. Në kryerjen e funksioneve të tij Sekretari i Përgjithshëm informon Presidentin dhe këshillohet me të.

KAPITULLI VI

DEGA E KKSH

Neni 25

ROLI DHE ORGANIZIMI I DEGËS

Dega është njësi bazë e KKSH. Degët krijohen për të siguruar praninë e veprimtarisë së KKSH në të gjithë territorin e vendit duke patur parasysht ndarjen administrative. Dega përbëhet nga anëtarët e KKSH të regjistruar në territorin e saj të veprimit. Dega organizon veprimtarinë e saj në territorin përkatës sipas orientimeve të dhëna nga Asambleja e Përgjithshme. Funksionimi i degëve përcaktohet në Rregulloren e Brendshme.

Neni 26

MBLEDHJA E ANËTARËVE TË DEGËS

- Është organi më i lartë i degës dhe përfaqëson tërësinë e anëtarëve të saj.
- Vendos mbi çështje që kanë të bëjnë me jetën dhe veprimtarinë e KKSH në territorin përkatës në përputhje me Statutin, Rregulloren e Brendshme dhe politikat e shoqatës.
- Përbëhet nga Këshilli i Degës dhe çdo anëtar i regjistruar që dëshiron të marrë pjesë në të.
- Zgjedh kryetarin e degës, zv-kryetarin, anëtarët e këshillit, kryetarin dhe anëtarët e komisionit të financës. Këto zgjedhje homologohen nga Këshilli Drejtues. Në rast mos homologimi, brenda dy muajve bëhen zgjedhje të reja.
- Mbledhja e anëtarëve të degës zgjedh gjithashtu delegatët për në Asambleshën e Përgjithshme më të afërme sipas numrit të caktuar nga Këshilli Drejtues.
- Mbledhja e anëtarëve të degës merr vendim me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm.

Neni 27

KËSHILLI I DEGËS

-Këshilli është organi drejtues i degës dhe mbledhet jo më rallë se çdo tre muaj. Ai përbëhet nga kryetari, zëvendës kryetari, kryetari i komisionit të financës dhe anëtarët e tjerë të këshillit. Numri i anëtarëve për çdo Këshill, caktohet nga Këshilli Drejtues.

- Këshilli i Degës zgjedh anëtarët e Komisionit të Kandidimit.

- Ai merr vendime mbi veprimtarinë dhe jetën e degës, në prani të jo më pak se gjysmës së anëtarëve të tij dhe me shumicë të votave të anëtarëve të pranishëm.

Kryetari i degës së KKSHT drejton veprimtarinë e degës që ajo të kryhet në përputhje me Statutin dhe Rregulloren e Brendshme, me vendimet e orientimet e Asamblesë, Këshillit Drejtues, Presidentit dhe Këshillit të Degës.

- Kryetari dhe Këshilli i Degës përgjigjen përpara Mbledhjes së anëtarëve të degës dhe Këshillit Drejtues të KKSHT-së.

- Këshilli i Degës merr pjesë në procesin e përzgjedhjes së sekretarit të degës nëpërmjet kryetarit të vet, sipas modaliteteve të përcaktuara në Rregulloren e Brendshme.

- Sekretari organizon dhe ndjek veprimtarinë e degës dhe raporton rregullisht në Këshillin e Degës. Ai përgjigjet për zbatimin e vendimeve të Këshillit të Degës dhe për të gjitha punët administrative, për të cilat informon dhe konsultohet me Kryetarin e Këshillit.

Neni 28

SHPËRNDARJA E KËSHILLIT TË DEGËS

Këshilli i degës shpërndahet kur:

1. Tregohet i paaftë të përmbushë detyrën e tij
2. Shkel Statutin dhe Rregulloren e Brendshme.
3. Ka mosmarrveshje të rënda në gjirin e tij dhe në marrëdhëniet me njësitë e tjera të KKSHT-së.
4. Refuzon të zbatojë vendimet e organeve drejtuese të KKSHT-së.

Neni 29

MODALITET E SHPËRNDARJES

Në rast shpërndarje të Këshillit të një dege, Këshilli Drejtues ngarkon një komision të posaçëm të përbërë së paku nga tre vetë për drejtimin e përkohshëm të Degës dhe përgatitjen e zgjedhjeve të reja të Këshillit të Degës në mbledhjen më të afërt të anëtarëve të kësaj dege.

Në raste të veçanta, Presidenti me pëlqimin e Këshillit Drejtues, pezullon përkohësisht një Këshill Dege, duke ia besuar drejtimin një të ngarkuari të përkohshëm të caktuar prej tij.

KAPITULLI VII

ZGJEDHJET/ ROTACIONI / PROFILET

Neni 30

ZGJEDHJET

Zgjedhja e Presidentit të Shoqatës dhe e Kryetarit të Degës bëhet përkatësisht nga Asambleja e Përgjithshme dhe Mbledhja e anëtarëve të degës.

Ata zgjidhen me shumicë absolute të anëtarëve me të drejtë vote të pranishëm në këto forume.

Anëtarët e organeve të tjera zgjidhen me shumicën e thjeshtë të votave.

Procedurat e zgjedhjeve përcaktohen në Rregulloren e Brendëshme.

Në të gjitha rastet zgjedhjet bëhen me votim të fshehtë.

Neni 31

KOHËZGJATJA E MANDATIT

Kohëzgjatja e mandatit për të zgjedhurit në organet drejtuese qendrore e të degëve është katër vjet.

Kur për arsye madhore Asambletë nuk mund të mbledhen për të zhvilluar zgjedhjet, me vendim të Këshillit Drejtues, të zgjedhurit në organet e mësipërme mbeten në postet e tyre përtej mandatit, deri në krijimin e kushteve për thirrjen e Asamblesë.

Kur ka vende të lira në organin e zgjedhur, këshilli përkatës koopton anëtarët me pëlqimin e shumicës së Këshillit.

Përsa kohë një anëtar është i kooptuar, ai nuk ka të drejtë vote vendimore.

Zëvendësimet në Këshillin Drejtues apo në këshillin e degës bëhen me zgjedhje nga Asambleja e Përgjithshme apo mbledhja e anëtarëve më e afërt. Afati i mandatit të tij do të përfundojë në fund të mandatit të zëvendësuar.

Neni 32

ROTACIONI

Të zgjedhurit nga Asambleja e Përgjithshme dhe nga mbledhja e anëtarëve të degës, nuk mund të kandidojnë për t'u zgjedhur përsëri në të njëjtin organ, pas përfundimit të tri mandateve të njëpasnjëshme.

Mandati jo i plotë nuk llogaritet kur për këtë ka arsye të mjaftueshme.

Presidenti dhe kryetarët e Degëve të cilët nuk rizgjidhen në të njëjtin post qëndrojnë automatikisht anëtarë të këshillit përkatës mbi numrin e përcaktuar, për një periudhë 1 vjeçare.

Neni 33

PROFILET

Për kandidatët në postet e të gjithë niveleve Këshilli Drejtues harton profilet përkatëse.

Modalitetet e kandidimit përcaktohen në Rregulloren e Brendëshme.

KAPITULLI VIII

USHTRIMI I FUNKSIONEVE

Neni 34

USHTRIMI FALAS I FUNKSIONEVE TË ZGJEDHURA

Funksionet e Presidentit dhe anëtarit të Këshillit Drejtues, të Kryetarit dhe anëtarit të Këshillit të Degës ushtrohen falas, por mund të ketë edhe kompensime.

Neni 35

RESPEKTIMI I ASNJANËSISË

Askush nuk mund të përmendë përkatësinë në KKSH për qëllime politike, etnike, fetare etj. Çdo thyerje e këtij rregulli mund të dënohet me sanksione që shkojnë deri në përjashtimin sipas nenit 12.

Neni 36

PËRPIKMERIA E ANËTARËVE TË ZGJEDHUR

Çdo anëtar i zgjedhur në një organ të KKSH që nuk tregon zellin dhe pjesëmarrjen e duhur, humbet të drejtën të jetë anëtarë Këshilli që nga çasti kur mungesa e tij pa arsye i kalon tri mbledhje rradhazi. Atëhere zëvendësohet sipas kushteve të parashikuara për rastet e vendeve të lira.

KAPITULLI IX

DISPOZITA FINANCIARE

Neni 37

TË PËRGJITHSHME

KKSH për të zhvilluar veprimtarinë e vet humanitare në kufijtë që i ka caktuar vetes, pranon, shet, zotëron, tjetëron dhe administron, çdo pasuri dhe mjet që i nevojitet.

KKSH mund të pranojë kontribute të pakufizuara dhe ndihma të çdo forme nga individë, autoritete dhe organizma private. Mund të pranojë donacione anonime deri në shifrën 1.000.000 lekë. Nuk mund të pranojë donacione që vijnë direkt nga të ardhura të veprimtarive që bien në kundërshtim me Parimet Themelore.

KKSH mund të pranojë donacione, pasuri, trashgimi ose uzufukt që i vlejné qëllimeve të Shoqatës.

KKSH duhet të përcaktojë një fond rezervë, sasinë dhe destinacionin e të cilit e vendos Këshilli Drejtues.

Neni 38

ADMINISTRIMI DHE KONTROLLI

Përdorimi i çdo fondi dhe i çdo pasurie të KKSH, duke përfshire dhe Degët i nënshtrohet kontrollit të Këshillit Drejtues.

Nuk mund të jepet asnjë hua pa pëlqimin e Këshillit Drejtues.

Këshilli Drejtues merr vendime financiare vetëm pas një shqyrtimi paraprak nga Komisioni i Financës.

Neni 39

VITI FINANCIAR

Viti financiar fillon më 1 Janar dhe mbaron më 31 Dhjetor të të njëjtit vit kalendarik.

Neni 40

TË ARDHURAT

Të ardhurat vjetore të KKSH-së përbëhen nga:

- kuotizacionet
- burime të siguruara nga veprimtaritë ekonomike për realizimin e objektivave të tij humanitare
- burime të ndryshme, trashëgimi etj
- subvencione të shtetit ose nga shoqëri të tjera publike
- burime të krijuara me autorizimin e pushteteve publike (p.sh. mbledhje ndihmash, festa në sheshe publike etj)

Neni 41

RAPORTI FINANCIAR

Sipas modeleve tip të aprovuara nga Këshilli Drejtues për nivelet e ndryshme, duhet të përdoret një kontabilitet në përputhje me dispozitat në fuqi.

Raportet administrative për gjendjen financiare të çdo Dege plotësojnë llogarinë vjetore në nivel kombëtar.

Ato ndihmojnë në hartimin nga ana e Këshillit Drejtues të raportit financiar që i paraqitet Asamblesë së Përgjithshme.

Neni 42

BUXHETI

Buxheti i KKSH hartohet nga Sekretari i Përgjithshëm, shqyrtohet e komentohet nga Komisioni i Financës dhe pas diskutimit në Këshillin Drejtues paraqitet për miratim në Asambleshën e Përgjithshme.

Buxheti i Degës hartohet nga sekretari i saj, shqyrtohet e komentohet nga Komisioni i Financës, dhe pas diskutimit në Këshillin e Degës, paraqitet për miratim në mbledhjen e anëtarëve të degës.

Neni 43

KONTROLLI I LLOGARIVE

Llogaritë e KKSH-së kontrollohen çdo vit nga kontrolli i brendshëm dhe subjekte oditimi të jashtëm.

KAPITULLI X

DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 44

RISHIKIMI I STATUTIT

Propozimet për ndryshimin e Statutit bëhen nga:

- Këshilli Drejtues;
- Jo më pak se gjysma e anëtarëve të Asamblesë së Përgjithshme;
- Jo më pak se tre Degë;

Propozimet e miratuara nga Këshilli Drejtues njoftohen një muaj përpara mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme dhe informohet Federata Nderkombetare e Kryqit të Kuq dhe Gjysmë Hënës së Kuqe dhe Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq.

Asambleja e Përgjithshme, miraton ndryshimet në Statut në prani të së paku 2/3 të anëtarëve të saj. Në qoftë se nuk arrihet ky numër, atëherë thirret një mbledhje e re brenda 15 ditëve. Në këtë rast vendimi që merret është i vlefshëm pavarësisht nga numri i të pranishmëve.

Miratimi bëhet me 2/3 e votave të anëtarëve të pranishëm.

Neni 45

RREGULLORET

Këshilli Drejtues miraton dhe ndryshon rregulloret e nevojshme për zbatimin e këtij Statuti.

Neni 46

SHPËRNDARJA

Shpërndarja e KKSH-së mund të shpallet vetëm me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të marrë në prani të jo më pak se 3/4 të anëtarëve që e përbëjnë Asamblenë dhe me votat e së paku 3/4 e anëtarëve të pranishëm.

Neni 47

HYRJA NË FUQI

Ky statut hyn tërësisht në fuqi më 1 janar 2008.

Me hyrjen në fuqi të këtij Statuti, të gjitha rregulloret dhe qarkoret shfuqizohen (për aq sa vijnë në kundërshtim me të).

Ngarkohet Këshilli Drejtues të përgatisë Rregulloren e Brendëshme dhe udhëzimet e tjera në zbatim të Statutit.

Aprovuar nga Asambleja XI e Përgjithshme e Kryqit te Kuq Shqiptar.

Mbajtur në Tiranë, më 10 Nëntor 2007.

Zamir MUÇA
SEKRETAR I PËRGJITHSHËM

Prof.Dr.Shyqyri SUBASHI
PRESIDENT